



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ENERGJISË
DHE INDUSTRIË
MINISTRI

URDHËR

NR. 150 datë 05.06.2015

**PËR NDRYSHIMIN E URDHËRIT NR. 124, DATË 12.05.2015 “PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE” DHE URDHËRIT NR. 132, DATË 15.05.2015. “PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIDHJEN E MARRËVESHJEVE
HIDROKARBURE”**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës, të nenit 9 të ligjit Nr.7746, datë 28.7.1993 “Për hidrokarburet (kërkimi dhe prodhimi)”, të ndryshuar, VKM nr. 335, datë 22.04.2015 “Për disa ndryshime në Vendimin nr. 279, datë 12.04.2012, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së objekteve të operacioneve hidrokarbure, pjesë e marrëveshjes së lidhur më 26.7.1993, ndërmjet Ministrisë së Industrisë, Burimeve Minerare dhe Energjetikës (sot Ministria e Energjisë dhe Industrisë) dhe Albpetrol-it, Bashkësisë Ekonomike të Naftës dhe Gazit (sot shoqëria “Albpetrol” sh.a)” dhe për zbatimin e synimit themelor për thithjen e investimeve të huaja, apo vendase, në fushën e kërkimit të naftës dhe gazit në territorin e Republikës së Shqipërisë, veçanërisht për blloqet e Lira Kërkimit, si dhe për të garantuar zhvillimin e një procedure të hapur, konkurruese,

URDHËROJ:

1. Pika 1 e Urdhrit nr. 124, datë 12.05.2015 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure” ndryshon si me poshtë:
“AKBN të publikojë, menjëherë, në faqen e saj të internetit hartën e blloqeve të lira të kërkimit në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe formularin e aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për blloqet 4, 5 dhe Dumre, i cili duhet të jetë deri më datën 15.07.2015.”
2. Pika 1 e Urdhrit nr. 132, datë 15.05.2015 “Për fillimin e procedurave për lidhjen e marrëveshjeve hidrokarbure” ndryshon si me poshtë:
“AKBN të publikojë, menjëherë, në faqen e saj të internetit hartën e blloqeve të lira të kërkimit në territorin e Republikës së Shqipërisë si dhe formularin e aplikimit. Pjesë e këtij publikimi duhet të jetë edhe vendosja e afatit të dorëzimit të aplikimit për blloqet C dhe Panaja, i cili duhet të jetë deri më datën 15.07.2015, ndërsa për blloqet e detit, për shkak të konsolidimit të të dhënave sizmike, të shtyhet për një afat tjetër”

3. Për zbatimin e këtij Urdhri ngarkohen AKBN, si dhe Drejtoria e Politikave dhe Zhvillimit të Hidrokarbureve në MEI.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

